



Pranim / Dorezuar Priljevo/Pridato Received/Delivety	28.03	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	1630/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.190/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Valentina Kaçandolli - Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.217/20 të datës 25.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.316/2019 të datës 10.06.2019 të parashtruar nga ankuesja [redacted] në Komunën e Suharekës, kundër Vendimit me Nr.01/016-35017 të datës 29.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.316/2019 e datës 10.06.2019 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01/016-35017 i datës 29.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Suharekës.

### A r s y e t i m

Komuna e Suharekës, me datë 01.04.2019 ka shpallur konkurs për plotësimin e pozitës Drejtor në Shkollën e Mesme të Ulët "Shkëndija". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit por e njëjta nuk është përzgjedhur si kandidate e suksesshëm për pozitën përkatëse të punës.

Komuna e Suharekës pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 15.05.2019 respektivisht 16.05.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 22.05.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Suharekës, me datë 29.05.2019 ka nxjerr Vendimin me Nr.01/016-35017 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 07.06.2019 nëpërmjet postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë në Këshill është pranuar më datë 10.06.2019 dhe ka marr numrin e protokollit 2630/2019, ndërsa numrin e lëndës A.nr.316/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.06.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Komuna e Suharekës. Kjo e fundit ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me datë 21.06.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje më datë 21.08.2020 ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën për ushtrimin e mjeteve ligjore në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative.

Ankuesja sipas njoftimit të Këshillit, ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 25.02.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.217/20 përmes të cilit ka anuluar njoftimin e datës 21.08.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shqyrtimin e ankesës të datës 10.06.2019 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2630/2019 të datës 10.06.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 16.05.2019; Njoftim i datës 15.05.2019; Ankesë e datës 22.05.2019 e parashtruar nga ankuesja ne Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në Komunën e Suharekës; Vendimi datës 29.05.2019 me numër protokollit 01/016-35017 i Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës ne Komunën e Suharekës; Kërkesa për punësim të ankueses së bashku me dëshmitë e përvojës se punës , përgatitjes profesionale dhe Certifikatat te ndryshme; Kërkesë për përgjigje e datës 11.06.2019 me numër 2649/2019; Përgjigje në ankesë e datës 21.06.2019; Autorizim për publikimin e konkursit e datës 27.03.2019 e lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike; Konkursin e datës 01.04.2019; Shkresa e datës 19.02.2019; Kërkesa e datës 13.02.2019; Aktvendim i datës 24.04.2019; Formulari A i datës 07.05.2019; Formulari B i datës 06.05.2019; Formulari C i datës 07.05.2019; Formulari D i datës 07.05.2019; Formulari E; Formulari H i datës 07.05.2019; Akt përcjellës i datës 15.05.2019; Procesverbal i datës 07.05.2019; Vendim i datës 20.05.2019 për Formimin e Komisionit të Ankesave; Protokollit i intervistimit i datës 07.05.2019; Kërkesa për punësim i kandidatit [REDACTED] se bashku me dëshmitë e përvojës se punës, përgatitjes profesionale dhe Certifikatat të ndryshme; Kërkesa për punësim e kandidatit [REDACTED] se bashku me dëshmitë e përvojës se punës, përgatitjes profesionale dhe Certifikatat te ndryshme; Kërkesa për punësim e kandidatit [REDACTED] se bashku me dëshmitë e përvojës se punës, përgatitjes profesionale dhe Certifikatat të ndryshme dhe Përgjigjen në ankesë e datës 21.06.2019; Njoftimin e datës 21.08.2019 për ankuesen;





Aktgjykimin A.nr.217/20 të datës 25.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kandidatët për pozitën Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në institucionet e caktuara kanë të drejtë të rizgjidhen pa konkurs publik por në bazë të vlerësimit të performancës dhe duhet të kenë të kryer arsimin universitar me së paku 240 kredi. Ankuesja pretendon se ka paraqitur portofolion më të pasur që ka pas ndonjëherë DKA në Suharekë dhe se kandidati i renditur në vendin e parë nuk ka përvojë në udhëheqje dhe menaxhim të shkollës, nuk ka mirënjohje për punën e kaluar, nuk e njih gjuhën angleze dhe nuk ka fare njohuri të programeve aplikative kompjuterike. Me tutje ankuesja konsideron se vlerësimi i kandidateve nuk është bërë në prani të këshillit të prindërve dhe shkollës por vetëm kanë detyruar të nënshkruajnë formularët e vlerësimit gjatë intervistimit, dhe se ende pa marr përgjigje nga komisioni i ankesave i është ndërprerë marrëdhënia e punës si drejtoresh e shkollës pa një aktvendim. E njëjta pretendon se ankesa i është refuzuar përmes shkeljes së dispozitave ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses analizoje dispozitat e nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, dhe rrjedhimisht konstatoi se me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ kandidatet e përzgjedhur për drejtor/zëvendësdrejtor kanë të drejte të rizgjedhin në të njëjtin institucion pa konkurs publik, në bazë të vlerësimit të performancës që rregullohet me akt të veçantë nënligjor, mirëpo sipas vlerësimit të Kolegjit ceshtja e rizgjedhjes pa konkurs është në diskrecionin e institucionit përkatës, respektivisht drejtorive të arsimit e cila fillimisht duhet të bëjë vlerësimin e performancës së drejtorit pastaj në bazë të këtij vlerësimi mund të rekomandoj vazhdimin apo jo të kontratës. Andaj, duke marr parasysh se ankuesja kontratën e punës e ka pasur me afat të caktuar, dhe meqenëse në shkresa të lëndës nuk ka rekomandim për vazhdim të kontratës nga organi i punësimit, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i pa bazuar, dhe se procedura e konkursit është shpallur në pajtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se kandidatet duhet të kenë të kryer arsimin universitar se paku 240 kredi, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se në bazë të Formularit "B" për pozitën Drejtor i Shkollës Filllore "Shkëndija" kanë aplikuar katër (4) kandidatë të cilët në bazë të provave të lëndës posedojnë diplomë të studimeve me së paku 240 kredi, ashtu siç kërkohet në konkurs e shpallur dhe rrjedhimisht të gjithë kandidatët sa i përket përgatitjes profesionale në mënyrë formale-juridike kanë plotësuar kushtet e konkursit të përcaktuar me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, kështu që pretendimi ankimor i ankueses është i paqëndrueshëm.



Kolegji, në bazë të provave të lëndës ka gjetur se ankuesja dhe kandidatet tjetër me rastin e aplikimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore "Shkëndija" kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara në konkurs, siç përcaktohet me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se kandidati i renditur në vendin e parë nuk ka përvojë në udhëheqje dhe menaxhim të shkollës, nuk ka mirënjohje për punën e kaluar, nuk e njeh gjuhën angleze dhe nuk ka fare njohuri të programeve aplikative kompjuterike, Kolegji shqyrtoje shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht konstatoi se kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- *Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (240 ECTS/ 4 vite) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit;*
- *Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;*
- *Të kenë se paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucion të arsimit;*
- *Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim;*

Kolegji, bazuar në kriteret e lartcekura të konkursit konstatoi se për pozitën e punës të cilën ka aplikuar ankuesja nuk është kërkuar në mënyrë obligative që kandidatët të njohin gjuhën e huaj ose të kenë të përfunduara programe kompjuterike apo të ngjashme. Ndërsa në bazë të provave të lëndës, rezulton se kandidati i përzgjedhur posedon Certifikatën e lëshuar nga OJQ "Kosova Hope" më të cilin ka kryer programin "Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për udhëheqje arsimore (168 orë), kështu që në këtë aspekt ka plotësuar kriterin e konkursit të përcaktuar me dispozitat e nenit 3 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i paqëndrueshëm.

Rrjedhimisht, Kolegji konstatoi se ankuesja dhe kandidati i përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe në bazë të formularit "E" ankuesja është vlerësuar me 76.33 pikë, ndërsa kandidati i përzgjedhur është vlerësuar me 85.33 pikë, andaj është emëruar kandidati që ka marr numrin më të madh të pikëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se vlerësimi i kandidateve nuk është bërë në prani të këshillit të prindërve dhe shkollës, analizoj shkresat e lëndës dhe duke ju referuar Formularit "A" konstatoi se pjesë e Komisionit për Përzgjedhje kanë qenë dy anëtar nga këshilli i shkollës, S.Bytyqi-mësimdhënës dhe R.Reshitaj-prind, dhe të njëjtit anëtar kanë marr pjesë në intervistimin e kandidatëve duke nënshkruar edhe formularin "H", kështu që me këtë rast është vepruar në pajtim me nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankueses nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se ende pa marr përgjigje nga Komisioni i Ankesave i është ndërprerë marrëdhënia e punës si drejtoresh e shkollës, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka gjetur se ankuesja ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka parashtruar me pretendimet ankimore për anulimin e konkursit të datë





01.04.2019, ndërsa kontratën e punës për drejtor të shkollës e ka përfunduar me datë 18.05.2019, andaj marrëdhënia e punës i ka përfunduar ankuese sepse është konsumuar koha për të cilën është lidhur kontrata (periudha 4 vjeçare) siç me nenin 8 paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët "Shkëndija" të shpallur nga Komuna e Suharekës është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Andaj, bazuar si me larte Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Suharekës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.01\016-35017 te datës 29.05.2019 për refuzimin si te pa bazuar të ankesës se ankueses ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, dhe Udhëzimin Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.190/2022

Valentina Kaçandolli - Bekteshi

Procesmbajtëse



Jeton KOCA  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës të Suharekës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

